



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 888/4 Prot.

Tiranë, më 09/10/2015

VENDIM  
“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 47, datë 09/10/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Z. , përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 3988 rep., nr. 1364/1 kol., datë 01.12.2014 nga Av. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 888/1 Prot., datë 05.10.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi, në cilësinë e kërkuessit, me shkresën e datës 02.09.2015 ka kërkuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, të informohet lidhur me:

- *Vendimin nr. 29, datë 13.08.1999 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.*
- *Informacion për dosjen nr. 2755, datë 25.08.1994 të bërë nga Z.*
- *Të gjitha dokumentat e paraqitura në dosjen ku është marrë vendimi nr. 29, datë 13.08.1999 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.*

Lidhur me sa më sipër Z. pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga ana e autoritetit publik dhe për këtë arsye ka bërë ankesë pranë Zyrës së Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me Urdhrin nr. 200 datë 08.10.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave. Pranë këtij autoritetit u depozitua Urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 3404 Prot., datë 08.10.2015.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Z. është depozituar pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave dhe është regjistruar me nr. 3498 Prot., datë 08.09.2015. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ndryshe nga sa pretendon Z. , Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave i ka kthyer përgjigje kërkuessit me shkresën nr. 3498/1 Prot., datë 07.10.2015 duke i bërë sqarimet përkatëse për sa ai ka kërkuar.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik/ Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ka përmbushur detyrimin në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duke i kthyer përgjigje kërkuessit.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Z. [Blank] ndaj Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave. Komisioneri vlerëson se ajo rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 888/1 Prot., datë 05.10.2015 të Z. [Blank], i përfaqësuar nga Av. [Blank], kundër Autoritetit Publik/ Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u dha sot në datë 09.10.2015.

**Besnik DERVISHI**  
  
KOMISIONERI

